



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 318/1 prot.

Shkodër, më 12.05.2025

Lënda: Mbi vendimin Nr. 27, Nr.28, datë 28.04.2025 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", neni 56 KPAD, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 23, pika 7, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 29, neni 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 44. paragrafi i II, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 109, shkronja "m", pika 120, shkronja "d", të VKQ Shkodër nr. 26, datë 20.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Këshillit të Qarkut Shkodër", të ndryshuar, të VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", të ndryshuar, të Akt Marrëveshjes nr. 1429 prot., datë 26.03.2025 "Për bashkëpunimin ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës" të lidhur mes Bashkisë Vau Dejës dhe Këshillit të Qarkut Shkodër", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2011 prot., datë 02.05.2025 "Shkresë përcjellëse", shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 27, datë 28.04.2025 "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës me nr. 1429 prot., datë 26.03.2025 dhe Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 200 prot., datë 26.03.2025 Për bashkëpunimin ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës", me shtesë fondi në buxhet në vlerën 12 000 000 lekë sipas detajimit të bërë të VKQ nr. 26, datë 20.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025" dhe VKB nr. 28, datë 26.06.2024 "Për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës në VKB Vau Dejës nr. 84, datë 23.12.2024".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 27 Datë 28.04 2025

“Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, Datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, Datë 26.03.2025 ‘Për Bashkëpunim Ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit ‘Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë ,Bashkia Vau Dejës’”

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1, të ndryshuar; Ligji Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”; VKB Nr.93, datë 21.12.2023 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”; VKQ Shkodër Nr.19, datë 28.12.2023 “Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër”; VKQ Shkodër nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”; VKQ Shkodër Nr.6, datë 13.03.2025 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”, Këshilli Bashkiak Vau Dejës:

VENDOSI :

1.Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025,dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025 “Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës” (Bashkëngjitur marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025 dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025).

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes si dhe Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve për kryerjen e procedurave të Prokurimit pranë Bashkisë Vau Dejës, cila do të informojë Qarkun për ecurinë e procedurave të investimit deri në fazën e marrjes në dorëzim të investimit. .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike, sipas përcaktimit të nenit 55 të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar.

Zv/Kryetari Këshillit
Frano PRENGA



Sekretari Këshillit
Ardian CELEPIJA

Miraturar me 22 vota

Vota pro 22

Vota kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 02.05.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. 1549 Prot

Vau Dejës, 07.04.2025

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

I nderuar Z. Kryetar.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Projekt-Vendimin, “Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025 “Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës”

Bashkëlidhur:

1. Projekt-Vendimi;
2. Relacion shpjegues mbi Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025;
3. Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

KRYETARI

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni



Datë: _____

Nr. Faqeve A4 të projekt-vendimi _____

Nr. Faqeve A4 të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETETEVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. Prot

Vau Dejës, 07.04.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 1 Datë. 07.04 2025

**“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MES BASHKISË
VAU DEJËS NR.1429 Prot, DATË 26.03.2025, DHE KËSHILLIT TË QARKUT
SHKODËR NR.200 PROT, DATË 26.03.2025 “PËR BASHKËPUNIM NDËRVENDOR
NË FUSHËN E SHËRBIMEVE PUBLIKE PËR KRYERJEN E INVESTIMIT
“RIKONSTRUKSION I RRUGËS SË VARREZAVE MELGUSHË, BASHKIA VAU
DEJËS”**

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të “Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1, të ndryshuar; Ligji Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”; VKB Nr.93, datë 21.12.2023 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”; VKQ Shkodër Nr.19, datë 28.12.2023 “Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër”; VKQ Shkodër nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”; VKQ Shkodër Nr.6, datë 13.03.2025 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”, ku në mbledhjen e datës ____/____/2025 të Këshillit të Bashkisë:

VENDOSI :

1.Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025,dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025 “Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës” (Bashkëngjitur marrëveshja e bashkëpunimit mes

Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025 dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025).

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e mëtejshme të procedurave të kalimeve financiare për vënien në zbatim të detyrimeve të marrëveshjes si dhe Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve për kryerjen e procedurave të Prokurimit pranë Bashkisë Vau Dejës, cila do të informojë Qarkun për ecurinë e procedurave të investimit deri në fazën e marrjes në dorëzim të investimit. .

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas **nenit 55** pika **6**, e ligjit Nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*".

KRYETARI

Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA JURIDIKE E PROKURIMEVE DHE ASETIVE
SEKTORI I ASISTENCËS LIGJORE KONTRATAVE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. Prot

Vau Dejës, 07.04.2025

Lënda: Relacion shpjegues mbi Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025, “Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës”.

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1, të ndryshuar; Ligji Nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”; VKB Nr.93, datë 21.12.2023 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”; VKQ Shkodër Nr.19, datë 28.12.2023 “Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër”; VKQ Shkodër nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”; VKQ Shkodër Nr.6, datë 13.03.2025 “Mbi disa ndryshime në VKQ nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”;

Në zbatim të VKB Nr.93, datë 21.12.2023 “Për miratimin e projekteve prioritare të bashkisë Vau Dejës për vitin 2024” dhe Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër :

1.Objekt i kësaj Akt-Marrëveshje, është bashkëpunimi ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike, për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rugës Melgushë, Bashkia Vau Dejës”, nga Qarku, ku përcaktohet si prioritet realizimi i këtij investimi.

Sa më lart, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës duke konsideruar propozimin e bërë u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë:

1.Të “Marrëveshjes së Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025, “Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës”.

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VAU DEJËS



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT SHKODER

Nr. 1429 Prot., me 23.03.2025

Nr. 200 Prot., me 16.03.2025

AKT – MARREVESHJE

Për

“ Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë , Bashkia Vau Dejës”

e lidhur mes

Këshilli i Qarkut Shkodër, përfaqësuar nga Kryetari Z. Edmond NDOU që në vijim të dispozitave të kësaj Akt-Marrëveshjeje, do të quhet “Qarku”

Dhe

Bashkia Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari Z. Kristian SHKRELI, që në vijim të dispozitave të kësaj Akt-Marrëveshjeje, do të quhet “Bashkia”.

Baza ligjore:

-Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1.

-Ligji nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”.

-VKB nr.93, datë 21.12.2023 “Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024”.

-VKQ Shkodër nr.19,date 28.12.2023”Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër”.

- VKQ Shkodër nr.26,date 20.12.2024 ”Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”.

- VKQ Shkodër nr.6,date 13.03.2025 ”Mbi disa ndryshime në VKQ nr.26, datë 20.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027”.

Lidhet kjo Akt-Marrëveshje, për bashkëpunim ndërvendor, si më poshtë;

Neni 1

Objekti i Akt-Marrëveshjes:

1. Objekt i kësaj Akt-Marrëveshjeje, është bashkëpunimi ndërvendor ne fushën e Shërbimeve Publike, për kryerjen e investimit ***“Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë , Bashkia Vau Dejës”***, nga “Qarku”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës , ku përcaktohet si prioritet realizimi i këtij investimi.

AM





Neni 2

Kushtet e marrëveshjes

1. "Qarku" merr përsipër të financojë projektin e Bashkisë Vau Dejës, në shumën totale 12,000,000 (Dymbëdhjetë milion) lekë me tvsh, sipas Preventivit të parashikuar, prej së cilit shuma 10,408,000 (Dhjetë milionë katërqind e tetë mijë) lekë është parashikuar në buxhetin e vitit 2025 nga transfertat e pakushtëzuar e vitit 2025 dhe pjesa tjetër, shuma 1,592,000 (Një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dhjetë mijë) lekë është planifikuar dhe miratuar nga fondet e trashëguara nga viti 2024, me objekt **"Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës"**, i cili do të prokurohet nga Bashkia.
2. Qarku do të kryejë transferimin e fondeve të planifikuara dhe të miratuara në buxhetin e vitit 2025, nga Këshilli i Qarkut Shkodër tek Bashkia për kryerjen e investimit për objektin **"Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës"**, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Afati i akt-marrëveshjes përfundon me kryerjen e investimit për të cilin Qarku do të vihet në dijeni.

Neni 3

Mënyra e lëvrimit të fondit/Burimi i Financimit

1. Qarku, në një kohë sa më të parë me fondet e planifikuara të vitit 2025 dhe përkatsisht shuma prej 12,000,000 (Dymbëdhjetë milion) lekë me tvsh, e planifikuar nga Trasferta e Pakushtëzuar e vitit 2025 dhe nga fondet e trashëguara nga viti 2024, bën menjëherë transferimin e kësaj shume nga Qarku tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt **"Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës"**.
2. Qarku, do kryejë procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.6 date 13.03.2025

Neni 4

Detyrimet e palëve

1. Qarku, në bazë të projektit të investimit **"Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës"** dhe vendimit të KQShkodër, do të kryejë transferimin e fondit për këtë investim.
2. Bashkia detyrohet të kryejë procedurat e prokurimit për këtë investim dhe ta përdorë shumën e transferuar nga Qarku, vetëm për investimin e planifikuar dhe të miratuar, sipas kësaj Akt-Marrëveshje në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

AM



Neni 5

Detyrimi për raportim

1. Bashkia detyrohet të respektojë kushtet e kësaj Akt-Marrëveshje duke ju referuar objektit të saj si dhe të njoftojë Qarkun për ecurinë e kryerjes së këtij investimi. Për këtë mban përgjegjësi struktura përgjegjëse e kryerjes së procedurave të Prokurimit pranë Bashkisë Vau Dejës, cila do të informojë Qarkun për ecurinë e procedurave të prokurimit e deri në fazën e marrjes në dorëzim të investimit.

Neni 6

Dispozita të Përgjithshme

1. Në rast mosmarrëveshjes që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, pala e interesuar do t'i drejtohet gjykatës kompetente.
2. Kjo marrëveshje përbëhet nga 3 fletë dhe hartohet në 4 kopje origjinale, 2 kopje do të mbahen nga Qarku, ndërsa 2 kopje të tjetra do t'i jepen Bashkisë.
3. Palët pasi e lexuan, e pranuan pa vërejtje dhe e nënshkruan me vullnetin e tyre të plotë.

Për Bashkinë

KRYETARI

Kristian SHKRELI



Për Qarkun

KRYETARI

Edmond NDOL

